



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJEVE

NJOFTIM

PËR KANDIDATËT QË KONKUROJNË PËR PORTALIN “MËSUES PËR SHQIPËRINË”, 2022 MBI PROCESIN E ANKIMIMIT TË VLERËSIMIT TË DOSJEVE

Mbështetur në Udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, si edhe shkresën e MAS “Për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, njoftojmë kandidatët që kanë aplikuar përmes sistemit online në portalin “Mësues për Shqipërinë”, 2022 se vlerësimi i dosjeve të dërguara prej tyre ka përfunduar

Të gjithë kandidatët mund të verifikojnë vlerësimin e tyre në hapësirën vetjake të portalit. Hedhja e pikëve është në përfundim të procesit. Shpallja e listës së kandidatëve që kanë aplikuar në fazën e parë dhe u është pranuar dhe vlerësuar dosja do të bëhet në faqen elektronike të DRAP Durrës <http://durres.arsimiparauniversitar.gov.al/>, në datën **24.06.2022**

Pas publikimit të listës, çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për vlerësimin e dosjes si edhe të të dhënave të tij të pasqyruara në listë.

Afati i ankimit është prej datës 24.06.2022 deri në datën 27.06.2022.

Për këtë, duhet të drejtohet pranë ZVAP (zyrës vendore të arsimit parauniversitar) në të cilën ka **VENDBANIMIN**. Pra kujdes në **ZVAP ku kandidat-i/ja ka vendbanimin** do të drejtojë ankesën e tij/saj.

Në çdo ZVAP do të ngarkohet një person përgjegjës i cili do të mbledhë ankesat dhe do i dërgojë përmes postës elektronike në DRAP Durrës.

Asnjë ankesë e cila mund të drejtohet në forma të tjera nuk do të merret parasysh.

Sqarim!

Kandidatëve të cilët kanë zgjedhur të mbajnë pikët e dosjes, u është shqyrtuar dokumentacioni përkatës në dosje, por nuk u është kryer rivlerësim i saj.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!